



INTERNATIONAL MONETARY FUND



Njoftim Shtypi Nr. 13/366
PER SHPERNDARJE TE MENJEHERSHME
27 Shtator 2013

International Monetary Fund
Washington, D.C. 20431 USA

Deklaratë në përfundim të Misionit të FMN-së në Shqipëri

Një ekip nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) vizitoi Tiranën në datat 19-27 Shtator 2013 për të diskutuar rreth buxhetit të vitit 2014 dhe sfidave të politikës ekonomike të Shqipërisë. Misioni u takua me Kryeministrin Rama, Ministrin e Financave Cani, Ministrin e Zhvillimit Ekonomik dhe Sipërmarrjes Ahmetaj, Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë Fullani dhe të tjerë zyrtarë publike, përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe partnerë ndërkombëtarë. Në fund të vizitës, z. Nadeem Ilahi, shef i misionit të FMN-së për Shqipërinë bëri deklaratën e mëposhtme:

“Ekonomia pritet të mbetet e dobët në vitin 2013 pavarësisht nga rritja e eksporteve. Stanjacioni i kreditimit, bilancet e dobëta të korporatave dhe rënia e dërgesave të emigrantëve priten të kufizojnë rritjen në rreth 1.7%. Ekonomia mund të rritet në mënyrë modeste në vitin 2014 nëse autoritetet fillojnë reformat e nevojshme strukturore.”

“Devijimet fiskale në gjysmën e parë të vitit 2013 bashkë me rritjen e faturave të papaguara dhe detyrimet e prapambetura të qeverisë të akumuluar sidomos në dy vitet e fundit dhe të vlerësuara nga misioni në rreth 4.1% të PBB-së) pritet ta çojnë borxhin publik në 70 përqind të PBB-së në fund të vitit 2013, në krahasim me 59 përqind në vitin 2010. Pa politikat e nevojshme dhe reforma strukturore, borxhi publik do të vazhdojë të rritet dhe mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike.”

“Për të ulur dobësitë dhe për të ankoruar pritshmëritë, misioni rekomandon që autoritetet të miratojnë një objektiv të besueshëm afat-mesëm për vitin 2018 dhe të synojnë që borxhi publik në raport me PBB-në të fillojë të ulet duke filluar nga viti 2015.”

“Buxheti i vitit 2014 duhet të fillojë procesin e një korrektimi të konsiderueshëm fiskal, por duke patur parasysh dhe gjendjen e dobët të ekonomisë. Një korrektim i besueshëm dhe ambicioz i bazuar në masa specifike dhe konkrete—duke përfshirë reformën tatimore dhe përmirësimin në administrimin e taksave—është thelbësor. Masat ndihmëse për shtresat në nevojë duhet të realizohen nëpërmjet shpenzimeve buxhetore të targetuara. Reforma në

sigurimet shoqërore, sektorin e energjisë dhe menaxhimin e financave publike duhet të jenë një prioritet në afatin e mesëm, krahas konsolidimit fiskal.

“Shlyerja e detyrimeve të prapambetura të qeverisë dhe faturave të papaguara do të forconte bilancet e sektorit privat, do të ndihmonte në rifillimin e kreditimit duke ulur kreditë nën standart dhe duke mbështetur kërkesën vendase. Misioni sugjeron dokumentimin sistematik të detyrimeve (përfshirë këtu dhe auditimin e tyre), shlyerjen e shpejtë dhe njëkohësisht zbatimin e reformave në menaxhimin e financave publike që do të parandalojë rishfaqjen e tyre në të ardhmen.”

“Politika monetare dhe menaxhimi i likuiditetit nga ana e Bankës së Shqipërisë mbetet e përgjithësisht e përshtatshme, në linjë me dobësinë ciklike të ekonomisë. Banka e Shqipërisë ka qenë gjerësisht e suksesshme në ankorimin e pritshmërive të inflacionit dhe në lehtësimin e presioneve për likuiditet në system. Megjithatë, transmetimi më i lehtë i politikës monetare në rritje më të shpejtë të kreditimit pengohet nga rritja e rreziqeve në ekonomi dhe nga niveli i lartë i huave nën-standart në sistemin bankar.”

“Niveli i lartë i kredive nën standart është tregues për gjendjen e vështirë të bilanceve të firmave private —pjesërisht pasojë e akumulimit të detyrimeve të prapambetura—janë një faktor i rëndësishëm në ngurrimin e bankave për kreditim për shkak të riskut të lartë. Misioni mirëpret përpjekjet e fundit për të parandaluar vonesat në gjyq dhe për të shpejtuar ekzekutimin e kolateralit, por inkurajon ndërmarrjen e masave të tjera, përfshirë këtu ristrukturimin e kredive, heqjen e shtrembërimeve tatimore dhe lehtësimin e marrëveshjeve jashtë gjyqit.